



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**  
**SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.**  
**NJËSIA PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Storage per sistemet e monitorimit”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- 30233140-4- Direct access storage devices (Dasd)
- 31625200-5- Sistemi alarmi anti-zjarr
- 31625300-6- Sisteme alarmi anti-vjedhje
- 35125300-2- Kamera Sigurie

**VLERA E FONDIT LIMIT: 22,180,000** (Njëzetë e dy milion e njëqind e tetëdhjetë mijë) **LEK PA TVSH dhe 240,668.40** (Dyqind e dyzetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë dyzetë) **Euro pa TVSH.**

\* **Shënim:** Vlerat në lekë janë konvertuar në monedhen euro me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë më datë 02.09.2026, me kurs kembimi **92,16** (Nentedhjetë e dy presje njezete e nente ) Lek/Eur.

Sigurimi i ofertës 2%: **443,600** (Katërqind e dyzetë e tre mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH dhe **4813,37** (Katër mijë e tetëqind e trembedhjetë presje tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSH e fondit limit, sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021.

\* **Shënim:** Vlerat në lekë janë konvertuar në monedhen euro me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë më datë 02.09.2026, me kurs kembimi **92,16** (Nentedhjetë e dy presje njezete e nente ) Lek/Eur.

**Argumentimi vlere e fondit limit:** Në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit , Autoriteti ynë kontraktor, ka zbatuar parashikimet e Nenit 76 të VKM Nr.285 pika 1 b duke marrë oferta nga operatorët ekonomik të fushës. Ofertat janë administruar në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit dhe janë pjesë e dosjes.

*Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe***
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

*Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.*

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligji 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” Sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të Urdhërit të Prokurimit, Nr. 1324 ,datë 24.07.2026, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: **“Storage per Sistemet e Monitorimit” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard Sh.a.”.**

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

## **I. ARGUMENTIMI KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në mbështetje të neneve 76 dhe 82 të Ligjit Nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenit 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës*, si dhe në nenin 30 të VKM Nr 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), nga data e zhvillimit të tenderit të jetë sa vlera e përlogaritur e marrëveshjes kuadër. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të marrëveshjes kuader sipas parashikimeve të pikes 2 a) të Nenit 43 të VKM-se.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë shlyer detyrimet financiare të taksave vendore të parashikuara nga Njësia/të e Pushtetit Vendor për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026, referuar Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i

ndryshuar, në të cilën/at janë regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi. Dokumentet provuese, vërtetimet e kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, **si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” ,në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet*

*në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 39% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të disponojë Autorizim të prodhuesit ose Distributorit të autorizuar të pajisjes **Storage për sistemet e monitorimit**. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të prodhuesit të paktën një ose disa nga këto të dhëna: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, kurse në rastin e Autorizimit nga Distributori i Autorizuar do të paraqitet dhe akt-marreveshja/akti përkatës. Autorizimi duhet të jetë i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën shqipe.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku citohet: 8. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi për tregtimin e objektit të prokurimit. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.*

**2.3.3** Për të vertetuar përputhshmerinë me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedën teknike/katalog/broshurë nga prodhuesi për pajisjen Storage për sistemet e monitorimit. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në faqen zyrtare të prodhuesit.

**Argumentimi:** Ky kriter në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b.fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Paraqitja e katalogëve apo skedave teknike për artikullin që është objekt prokurimi, është kërkuar me qellim

verifikimin e përputhshmërisë të artikujve që operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike të percaktuara në DST, për të bërë të mundur vlerësimin e tyre dhe përmbushjen e kërkesave.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, (te përkthyer në shqip dhe te noterizuara) të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si me poshtë.

- ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë
- ISO/IEC 20000-1 ose ekuivalente për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit.

*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.*

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.*

**Shënim:** AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/IEC, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.* Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

**ISO 9001 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose ekuivalent** - Përmbushja e standardit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara

dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. Nisur nga proceset e punës dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, t'i bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara.

**ISO 20000-1 mbi “Menaxhimin e shërbimit” ose ekuivalent.** ISO 20000-1 ose ekuivalent është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Duke qenë se objekti i prokurimit nuk konsiston vetëm në furnizimin me pajisje Storage, por përfshin instalimin, konfigurimin, integrimin me infrastrukturën ekzistuese, migrimin e të gjitha të dhënave të sistemit aktual, testimin dhe vënien në funksion të zgjidhjes, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë certifikimin **ISO/IEC 20000-1:2018** ose ekuivalent. Gjatë realizimit të kontratës, operatori ekonomik do të kryejë procese kritike të menaxhimit të shërbimeve IT, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në disponueshmërinë, vazhdimësinë dhe funksionimin e sistemit të monitorimit. Standardi ISO/IEC 20000-1 garanton që operatori zbaton procese të dokumentuara dhe të kontrolluara për menaxhimin e ndryshimeve, konfigurimeve, incidenteve, planifikimin dhe ekzekutimin e migrimit, backup dhe rikuperimin e të dhënave, si dhe validimin e shërbimit pas implementimit. Zbatimi i këtyre proceseve është thelbësor për të garantuar migrimin e sigurt të të dhënave, ruajtjen e integritetit të tyre, minimizimin e ndërprerjeve gjatë implementimit, si dhe funksionimin e pandërprerë 24/7 të sistemit. Për rrjedhojë, kërkesa për ISO/IEC 20000-1:2018 ose ekuivalente është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që do të realizohen dhe synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon një sistem të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT, të aftë për të realizuar implementimin dhe migrimin në mënyrë të kontrolluar, të dokumentuar dhe me risk minimal për funksionimin e sistemit.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar për periudhën e tre muajve të fundit nga data e shpalljes së tenderit të paktën **3 (tre)** punonjës nga të cilët:

- 1(nje) punonjes te pajisur me Certificate per Menaxhimin e Projekteve Profesionale P M P/ PRINCE 2 lëshuar nga Project Management Institute (P M I) ose ekuivalente;
- 1(nje) punonjes te diplomuar ne fushat inxhinieri telekomunikacioni/ elektronik/informatike ose TIK
- 1(nje) punonjes te certifikuar nga prodhuesi i pajisjes storage te ofertuar.

Per punonjesit e mesiperm duhet te paraqitet :

- Diploma perkatese sipas legjislacionit per inxhinierin e telekomunikacionit; inxhinierin elektronik, informatike ose specialistin TIK;
- Certifikatat e trajnimit per punonjesin e certifikuar nga prodhuesi i pajisjes storage dhe P M P/ PRINCE 2 ose ekuivalent;
- Duhet te figurojne ne listepagesat e kompanise E-Sig per 3 muajt e fundit.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 9, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit**

**Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kerkese është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

**Për realizimin e këtyre proceseve kërkohet angazhimi i personelit me profile të ndryshme profesionale:**

**Punonjësi me certifikim PMP/PRINCE2 ose ekuivalent** është i nevojshëm për planifikimin, organizimin, koordinimin dhe monitorimin e të gjitha fazave të realizimit të kontratës. Duke qenë se projekti përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin, integrimin me infrastrukturën ekzistuese, migrimin e të dhënave, testimin dhe vënien në funksionim, kërkohet një person me kompetenca të menaxhimit të projekteve për të koordinuar aktivitetet dhe burimet e nevojshme, për të ndjekur ecurinë e zbatimit, për të menaxhuar ndërrarësitë ndërmjet aktiviteteve dhe për të siguruar realizimin e tyre brenda afateve dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë.

**Punonjësi i diplomuar në inxhinieri telekomunikacioni, elektronikë, informatikë ose TIK** është i nevojshëm për realizimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve teknike që lidhen me implementimin. Ky profil siguron kompetencën profesionale për instalimin fizik të pajisjes, konfigurimin e lidhjeve të rrjetit dhe komponentëve të storage-it, përshtatjen me infrastrukturën ekzistuese, konfigurimin e parametrave të komunikimit dhe integrimin me sistemet aktuale të monitorimit. Gjithashtu, ky person është i nevojshëm për kryerjen e verifikimeve teknike, testimin e komunikimit dhe funksionalitetit të sistemit dhe identifikimin e problematikave që mund të shfaqen gjatë implementimit.

**Punonjësi i certifikuar nga prodhuesi i pajisjes Storage** është i nevojshëm për të garantuar ekspertizën specifike mbi platformën teknologjike që do të implementohet. Ky person do të angazhohet në konfigurimin e avancuar të pajisjes, parametrizimin e storage-it dhe RAID-it, konfigurimin e redundancës dhe mekanizmave të mbrojtjes së të dhënave, si dhe në optimizimin e performancës së sistemit. Gjithashtu, ekspertiza e certifikuar nga prodhuesi është e rëndësishme gjatë procesit të migrimit të të dhënave, implementimit dhe integritetit me sistemet ekzistuese, diagnostikimit të problematikave dhe kryerjes së testeve përpara vënies së sistemit në funksionim, me qëllim garantimin e integritetit të të dhënave dhe funksionimit të qëndrueshëm të platformës.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë te pakten **1 (një) automjet** për realizimin e kontrates, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Lejen e qarkullimit
- Policen e sigurimit
- Çertifikaten e kontrollit teknik

- Taksat vjetore

Ne rast se mjetet e lartpermendura jane marre me qera ofertuesi duhet të paraqesë **Kontratën e marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 9, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.**

**Argumentimi:** Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mesiperme i sherben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve ku përfshihet levrimi dhe disponibiliteti në raste problematikash brenda afateve të garancise.

**2.3.7.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se afati i levrimit do të jete 60 dite nga nënshkrimi i kontratës.

**Argumentim:** Ky kriter është në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga nënshkrimi i kontratës përcaktohet në funksion të kompleksitetit teknik të objektit të prokurimit, i cili përveç furnizimit të pajisjes Storage përfshin instalimin, konfigurimin, integrimin me infrastrukturën ekzistuese, migrimin e të dhënave, testimin dhe vënien në funksionim.

Ky proces kërkon koordinim dhe realizim të njëpasnjëshëm të disa aktiviteteve teknike, përfshirë verifikimin e përputhshmërisë me infrastrukturën ekzistuese, konfigurimin e platformës, migrimin e sigurt të të dhënave dhe testimin e funksionaliteteve, pa cënuar vazhdimësinë dhe integritetin e sistemit ekzistues të monitorimit.

Për këtë arsye, afati 60-ditor konsiderohet i arsyeshëm, proporcional dhe i nevojshëm për realizimin e plotë, të sigurt dhe funksional të objektit të kontratës, duke garantuar që procesi i instalimit, integritetit dhe migrimit të kryhet në mënyrë të kontrolluar dhe pa rrezikuar të dhënat ekzistuese.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. ARGUMENTIMI I MOS NDARJES NË LOTE

Në zbatim të nenit 39 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 42 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se procedura e prokurimit me objekt "**Storage për Sistemet e Monitorimit**" nuk është e përshtatshme për t'u ndarë në lote, për arsye të mëposhtme:

Objekti i kësaj procedure prokurimi përbën një zgjidhje të integruar teknologjike, e cila përfshin furnizimin me pajisje Storage, instalimin fizik, konfigurimin logjik, integrimin me infrastrukturën ekzistuese të monitorimit, migrimin e të dhënave ekzistuese, konfigurimin e mekanizmave të backup-it dhe rikuperimit, testimin funksional dhe vënien në funksion të plotë të sistemit.

Ndarja e objektit në lote do të krijonte vështirësi teknike dhe operative, pasi komponentët e kësaj zgjidhjeje janë të ndërlidhur dhe kërkojnë një përgjegjësi të unifikuar për projektimin, implementimin dhe funksionimin përfundimtar të sistemit. Procesi i migrimit të të dhënave video, konfigurimi i parametrave të ruajtjes, integrimi me pajisjet ekzistuese NVR/kamera IP dhe optimizimi i performancës së sistemit kërkojnë koordinim të centralizuar dhe njohje të plotë të arkitekturës së zgjidhjes.

Ndarja në lote do të mund të sillte paqartësi në përcaktimin e përgjegjësi ndërmjet operatorëve ekonomikë, veçanërisht në rast të problematikave gjatë integritit, migrimit ose funksionimit të sistemit, duke e bërë më të vështirë identifikimin e përgjegjësit teknik dhe zgjidhjen e incidenteve. Gjithashtu, një ndarje e tillë mund të rrisë rrezikun e mospërputhjeve teknike ndërmjet komponentëve hardware dhe software, vonesave në implementim dhe vështirësive në garantimin e nivelit të kërkuar të disponueshmërisë së sistemit.

Duke qenë se sistemi i monitorimit kërkon funksionim të vazhdueshëm 24/7, integritet të të dhënave video dhe një proces migrimi të kontrolluar pa humbje informacioni, realizimi i objektit nga një operator ekonomik i vetëm siguron një pikë të vetme përgjegjësie, koordinim më efektiv të fazave të implementimit dhe ulje të rrezikut operacional.

Për rrjedhojë, mosndarja e kësaj procedure në lote është e justifikuar teknikisht dhe ekonomikisht, pasi garanton realizimin e një zgjidhjeje të unifikuar, funksionale dhe të testuar në tërësi, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimit dhe përmbushjen e kërkesave funksionale të sistemit të monitorimit.

## III. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KËRKESAVE FUNKSIONALE

Specifikimet teknike dhe kërkesat funksionale janë hartuar nga grupi i posaçëm i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, dhe nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "**Për Prokurimin Publik**", si dhe me nenin 40, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**", i ndryshuar.

Në zbatim të këtyre dispozitave, specifikimet teknike janë hartuar duke përcaktuar karakteristikat minimale funksionale dhe teknike që duhet të përmbushë objekti i prokurimit, me qëllim garantimin e cilësisë, performancës, besueshmërisë, sigurisë dhe përputhshmërisë me nevojat reale të Autoritetit Kontraktor, pa krijuar kufizime të pajustificuara për konkurrencën. Procedura e prokurimit me objekt "**Storage për Sistemet e Monitorimit**" synon zgjerimin dhe modernizimin e infrastrukturës qendrore të ruajtjes së të dhënave (Enterprise Storage), e cila mbështet sistemet elektronike të monitorimit të administruara nga "**Illyrian Guard**" Sh.A.. Këto sisteme funksionojnë në mënyrë të pandërprerë, 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë (24/7), duke gjeneruar

vazhdimisht një volum të konsiderueshëm të dhënash video që duhet të ruhen, administrohen dhe mbrohen në mënyrë të sigurt.

Hartimi i specifikimeve teknike është bazuar në analizën e nevojave aktuale dhe afatgjata të Autoritetit Kontraktor, duke marrë në konsideratë zgjerimin e vazhdueshëm të rrjetit të monitorimit, rritjen e volumit të të dhënave, nevojën për disponueshmëri të lartë të sistemit, si dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe mbrojtjes së informacionit.

#### **Argumentimi i kërkesave funksionale**

Kërkesa për **regjistrim të pandërprerë 24/7** është vendosur për të garantuar ruajtjen e vazhdueshme të të dhënave video, pa humbje informacioni, duke siguruar vazhdimësinë e monitorimit dhe disponueshmërinë e të dhënave në çdo kohë.

Mbështetja për **regjistrimin sipas ngjarjeve (Event-Based Recording)** synon optimizimin e kapaciteteve të ruajtjes dhe administrimin më efikas të të dhënave, pa cenuar cilësinë e monitorimit.

Kërkesa për **integrim të plotë me kamerat IP, pajisjet NVR dhe platformën ekzistuese të menaxhimit** është përcaktuar për të garantuar ndërveprueshmërinë me infrastrukturën ekzistuese, ruajtjen e investimeve të kryera dhe shmangien e kostove shtesë për zëvendësimin ose përshtatjen e sistemeve aktuale.

Kërkesat për **kontroll të aksesit sipas roleve, regjistrimin e veprimeve administrative (Audit Log) dhe administrimin e centralizuar** janë vendosur për të garantuar sigurinë e informacionit, gjurmueshmërinë e veprimeve dhe administrimin efikas të infrastrukturës.

Kërkesa për **mekanizma Backup dhe rikuperimi të të dhënave** është e domosdoshme për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe rikthimin e sistemit në funksionim normal në rast incidentesh ose dështimesh teknike.

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

| <b>Specifikimi teknik</b>                                              | <b>Argumentimi teknik</b>                                                                                                                       |
|------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Sistem Storage profesional, tip Cluster, për Video Surveillance</b> | Kërkohet për ruajtje të centralizuar, të qëndrueshme dhe të disponueshme 24/7 të të dhënave video të sistemeve të monitorimit.                  |
| <b>PCI-E 3.0 bus; Modular dhe pa kabllo</b>                            | Siguron komunikim të përshtatshëm ndërmjet komponentëve dhe mundëson mirëmbajtje dhe zgjerim më të lehtë të sistemit.                           |
| <b>Procesor 64-bit multi-core</b>                                      | Siguron kapacitet të mjaftueshëm për përpunimin paralel të operacioneve të ruajtjes, menaxhimit dhe komunikimit me shumë burime video.          |
| <b>Memorie eperkohshme minimum 64 GB</b>                               | Siguron kapacitet të mjaftueshëm për cache, menaxhimin e I/O dhe operimin e qëndrueshëm të një storage-i me numër të madh disqesh.              |
| <b>Minimum 48 HDD</b>                                                  | Siguron kapacitet të lartë ruajtjeje dhe mundëson shpërndarjen e ngarkesës së I/O në një numër të madh disqesh.                                 |
| <b>Interface HDD – SATA</b>                                            | SATA është ndërfaqe e standardizuar dhe e përshtatshme për HDD Enterprise me kapacitet të lartë, të përdorura për ruajtje të vazhdueshme video. |

| <b>Specifikimi teknik</b>                                                  | <b>Argumentimi teknik</b>                                                                                                                      |
|----------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>HDD min. 10 TB / 16 TB / 20 TB (Enterprise HDD)</b>                     | Kapacitetet e larta mundësojnë ruajtjen e sasive të mëdha të materialeve video dhe zgjasin periudhën e ruajtjes në të njëjtën hapësirë rack.   |
| <b>RAID inteligjent dhe tolerancë ndaj dështimit të disqeve</b>            | Siguron redundancë të të dhënave dhe vazhdimësi të shërbimit edhe në rast dështimi të një ose më shumë disqeve brenda kufirit të RAID-it.      |
| <b>SMART – alarm paraprak dhe riparim</b>                                  | Mundëson monitorimin e gjendjes së HDD-ve dhe identifikimin e hershëm të disqeve me probleme, duke reduktuar rrezikun e humbjes së të dhënave. |
| <b>Bateri backup për të dhënat e përkohshme</b>                            | Mbron të dhënat që ndodhen në cache gjatë ndërprerjeve të energjisë dhe redukton rrezikun e humbjes ose korrupsionit të të dhënave.            |
| <b>Funksione regjistrimi dhe ruajtjeje</b>                                 | Sigurojnë menaxhimin, ruajtjen dhe aksesin në materialet foto/video të sistemit të monitorimit.                                                |
| <b>GUI Web, CLI Serial, platformë menaxhimi</b>                            | Mundësojnë administrim, konfigurim dhe diagnostikim të sistemit përmes ndërfaqeve të ndryshme.                                                 |
| <b>Alarme me indikatorë, email dhe SMS</b>                                 | Mundësojnë njoftim të menjëhershëm për dështime të disqeve, RAID-it, energjisë, temperaturës dhe komponentëve të tjerë kritikë.                |
| <b>Protokolle rrjeti RTSP, ONVIF, PSIA</b>                                 | Sigurojnë interoperabilitet me pajisje dhe sisteme të ndryshme të Video Surveillance, duke reduktuar varësinë nga një prodhues specifik.       |
| <b>Interface rrjeti- Minimum 6 × 1000 Mbps, e zgjerueshme deri 8 × GbE</b> | Siguron bandwidth të mjaftueshëm për trafikun e të dhënave video dhe mundëson redundancë, agregim dhe zgjerim të lidhjeve të rrjetit.          |
| <b>Interface rrjeti menaxhimi- 1 × 1000 Mbps Management Port</b>           | Siguron kanal të dedikuar për administrimin e pajisjes, të ndarë nga trafiku kryesor i të dhënave.                                             |
| <b>Furnizim energjie redundant 2+1</b>                                     | Siguron vazhdimësinë e funksionimit në rast dështimi të një moduli të furnizimit me energji.                                                   |
| <b>Fuqia e furnizimit ≤1600 W</b>                                          | Përcakton kërkesën për infrastrukturën elektrike, UPS dhe PDU të ambientit ku instalohet pajisja.                                              |
| <b>Konsumi me HDD ≈770 W</b>                                               | Mundëson planifikimin e kapacitetit elektrik dhe të ftohjes së nevojshme për funksionimin e storage-it me disqe të instaluar.                  |

## Specifikimi teknik

## Argumentimi teknik

**Temperatura e punës 7°C deri +33°C**

Siguron funksionim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të pajisjes në ambientet e kontrolluara të server-room/data-center.

**Temperatura e ruajtjes 0°C deri +60°C**

Siguron ruajtjen e sigurt të pajisjes jashtë kushteve të operimit dhe gjatë transportit ose magazinimit.

**Rack standard**

Mundëson instalimin e pajisjes në rack-et standarde të infrastrukturës IT pa kërkuar zgjidhje fizike të personalizuar.

**module energjie Minimum 2, redundant**

Siguron redundancë të furnizimit dhe mundëson vazhdimin e punës edhe në rast të dështimit të një moduli.

**Minimum 1 × RS-232**

Mundëson konfigurimin fillestar dhe diagnostikimin lokal të pajisjes në rast të mungesës së aksesit në rrjet.

**Minimum 5 porta LAN**

Mundëson lidhje të shumta rrjeti, ndarje të trafikut dhe konfigurime redundante sipas kërkesave të infrastrukturës.

**Minimum 3 porta USB**

Sigurojnë fleksibilitet për mirëmbajtje, diagnostikim dhe lidhjen e pajisjeve periferike të autorizuar.

**Minimum 2 porta SAS**

Mundësojnë lidhjen me njësi të jashtme zgjerimi dhe rritjen e kapacitetit të storage-it sipas nevojave të ardhshme.

**Minimum 1 portë LAN e dedikuar për menaxhim**

Siguron administrim të pavarur dhe të kontrolluar të pajisjes, edhe kur rrjeti i të dhënave është i ngarkuar ose ka probleme.

### Argumentimi i kompatibilitetit dhe sigurisë

Kërkesa që sistemi të jetë plotësisht kompatibil me infrastrukturën ekzistuese të "**Illyrian Guard**" Sh.A. është vendosur për të garantuar funksionimin normal të sistemeve të monitorimit, ruajtjen e investimeve ekzistuese dhe eliminimin e kostove shtesë që do të sillte zëvendësimi i platformave aktuale.

Po kështu, kërkesat për redundancë, kontroll aksesit, auditim, mbrojtje të të dhënave dhe rikuperim në rast incidenti janë të domosdoshme për një infrastrukturë kritike që mbështet shërbime të sigurisë elektronike dhe operon në regjim të pandërprerë.

## NJËSIA E PROKURIMIT